
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: Lorenzo & Co Sh.p.k.; EURO – ING SH.P.K.; GEOCAD Group SH.P.K., Rruga Dritan Hoxha, P. 117, përballë Procredit Bank, 1000, Tirane Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **26.06.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Lorenzo & Co Sh.p.k.** me adresë në **Tirane**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Lorenzo & Co Sh.p.k.** me adresë në **Tirane**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **21.06.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Lorenzo & Co Sh.p.k.** me adresë në **Tirane**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **21.06.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.06.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesa 5: OE te dëshmoj me dokument relevant që është i licencuar apo ka marrëveshje me një OE Institut te licencuar ne vendin ame per ofrimin e trajnimeve ne QGIS;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 5: Operatori Ekonomik duhet të paraqes dokumentin e noterizuar apo marrëveshjen e bashkëpunimit te vulosur dhe nënshkruar;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar marrëveshje me persona që kanë ndjekur trajnimin QGIS, por që kjo gjë nuk e plotëson kërkesën e AK–së, po ashtu Grup i Operatorëve Ekonomik nuk janë të licencuar për të mbajtur trajnime në QGIS dhe nuk kanë as ndonjë marrëveshje me ndonjë kompani të Licencuar për trajnime ne QGIS, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit